



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në mbështetje me nenin 47, paragrafi (1), pika 6) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18) dhe nenin 64 paragrafi (3) nga Ligji për Bankat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 67/07, 90/09, 67/10, 26/13, 15/15, 153/15, 190/16 dhe 7/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 101/19), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi

VENDIM

për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për metodologjinë e përcaktimit të përshtatshmërisë së kapitalit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 116/ 20)

1. Në Vendimin për metodologjinë e përcaktimit të përshtatshmërisë së kapitalit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 47/12, 50/13, 71/14, 223/15, 218/16 dhe 221/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 181/19) në pikën 6 nënpika 12) në paragrafin 3 shtohet nënparagrafi 3 që thotë:

"-Fondi i sigurimit pensional dhe invalidor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Fondi i Sigurimit Shëndetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut;"

Nënparagrafi 3 bëhet nënparagrafi 4.

2. Në pikën 51) paragrafi (2) ndryshohet dhe thotë:

"Banka është e detyruar t'i zbatojë ponderët e rrezikut nga pika 50 të këtij vendimi të kërkesave nga të gjitha institucionet e tjera publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut."

3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e publikimit të tij në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

V. nr. 02 - 15/ VI-5/2020
28 qershor 2020
Shkup

Guvernatorja dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë së Veriut
д-р Анита Ангеловска-Бежоска

